



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 060/01-28888/20
Kaçanik, 19.11.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X-të (Dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 19 Nëntor 2020. Për shkak të distancës fizike lidhur me pandeminë Covid-19, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Lika (Troni).

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi dhe Festim Neziraj, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X-të (Dhjetë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 19 Nëntor, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020;
3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, sipas buxhetit të vitit 2020;
4. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës;
5. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
6. Kërkesa e anëtares së KK nga AAK, Rabije Sallahi, për ndryshim plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF); dhe
7. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Pika e 7 nuk ishte në Ftesën për mbledhje, materiali për këtë pikë është dërguar me vonë. Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX-të (Nëntë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 26.10.2020 / Lënda: 01Nr. 060/01-26603/20.

2. Raporti Nëntëmuor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin për këtë pikë e keni marrë, drejtori është prezent këtu për na dhënë sqarime të nevojshme në këtë raport financiar, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Nga raporti financiar shihet së të HVK kanë shënuar ngecje të inkasimit në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si fjala vjen të gjobat e inspektoratit kemi ngecje në vend së të jetë e kundërta, të shfrytëzimi i pronës komunale ka një rënie të lehtë të HVK, gjithashtu një rënie të lehtë kemi edhe të gjobat në trafik Rritje të HVK kemi të lejet e ndërtimit dhe të taksat për regjistrimin e trashëgimisë. Sa i përket shpenzimeve të realizuara janar-shtator 2020, kemi dyfishim të shpenzimeve të pozicioni: Mallrat dhe shërbimet, kjo sigurisht për shkak të pandemisë, ndërkaq ulje të shpenzimeve kemi të kategoria e Subvencioneve dhe transfereve. Për mendimin tim nuk ka logjikë me pasur ulje të shpenzimeve në këtë pozicion, kur dihen nevojat e qytetarëve të komunës. Shpenzimet komunale të realizuara nga raporti shihet së shpenzimet e ujit dhe të energjisë elektrike kanë shënuar ulje, ndërkaq ngritje të shpenzimeve shihet së kemi të mbeturinat. Të Investimet kapitale, për këta tre muaj është vështirë me arritur me u realizuar projektet që ende nuk kanë filluar. Kërkesa ime është që koha e cila është në dispozicion, të realizohen projektet sipas standardeve e jo shkel e shko, dhe të shpenzohen mjetet e planifikuara në këtë kategori ekonomike buxhetore.

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve, Për mua shqetësuese është rënia e inkasimit e të HVK. Totali është 52.8%, me çka kujtoj së nuk ka mundësi për tre muajt e mbetur me arritur atë çka është planifikuar me buxhet. Po ashtu të subvencionet dhe transfert rënia e shpenzimeve të këtyre mjeteve është shumë e madhe, 57 %, ndërkaq dihen nevojat e qytetarëve dihen e sidomos në kohë pandemie. Në këtë raport financiar në krahasim me raportet tjera që i kemi marrë, shihet së raportit i mungojnë; 1. Tabelari ku paraqitet planifikimi i buxhetit, alokimi dhe shpenzimi dhe 2. Tabelari që paraqet përmbledhjen e shpenzimeve për mallra e shërbime e të HVK. Të gjobat nga trafik, nuk është planifikuar ky pozicion, për atë nuk kemi të dhëna për realizim.

z. Nexhat Loku, Sa i përket raportit financiar, rënien e të HVK, unë kam dashur me debatuar këtë çështje me kolegët e mi, por duke marrë parasysh faktin së ka qenë vit pandemie, dhe normal se ka rënie të të HVK. Disa ngecje në realizim të HVK janë si rezultat i disa vendimeve të ministrive, si të regjistrimi i automjeteve me çka e dimë së për një kohë është pezulluar regjistrimi i automjeteve dhe kjo ka ndikuar në rënien e inkasimit të HVK. Ne e dimë së pandemia e ka bërë të veten në rënien e të HVK jo vetëm në komunën tonë, por edhe në tërë Kosovën.

z. Bahri Selimi, Të HVK shqetësimi i juaj është me vend, por ashtu si e tha z. Nexhat janë arsyet që kanë ndikuar në uljen e të HVK. Të HVK janë realizuar 63% e tyre, arsyet e uljes së inkasimit janë; mungesa e mërgatës, heqja e ndëshkimeve dhe kamatave nga niveli qendror, situata e rëndë në pandemisë nuk kemi aplikuar vërejtje nga 11 marsi dhe nuk i kemi dërguar palët në procedurë përmbartimore. Taksa e regjistrimit të automjeteve, taksat lidhen edhe me pagimin e tatimit në pronë, kemi pasur rritje të HVK të lejet e ndërtimit. Sivjet kemi pasur pagesa të pronave publike në f. Strazhë, kjo ka ndikuar në rritjen e të HVK. Shpenzimet të Mallrat dhe shërbimet, është e vërtetë së kanë shënuar ngritje për shkak të shumës 100.000,00€ të ndara për menaxhimin e pandeminë për pako ushqimore. Rritja e shpenzimeve buxhetore ka vazhduar të DAK për shkak të kontratës kolektive. Investimet kapitale deri në fund të muajit shtator kanë qenë 24 %, mirëpo tani është tjetër gjendje, sepse shpenzimet janë realizuar mbi 50%. Gjendja aktuale është mbi 80% e realizimit të buxhetit. Subvencionet kanë shënuar ulje, për shkak së janë anuluar shumë festivale ndërkombëtare. kombëtare jo vetëm të ne, por në përgjithësi në nivel të Kosovës, kështu ne i kemi anuluar disa aktivitete të SHKA. Tabelën e mallrave dhe shërbimeve, e kam parasysh dhe do t'iu dërgojmë për seancë të KK. Të HVK realizimi 23 % të hyrat direkte janë 55.51 % , në total 67.44 % Në vazhdim drejtori Selimi sqaroj edhe mjetet e shpenzuara nga Granti qeveritar dhe nga mjetet e shpenzuara nga HVK.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Raportin financiar a jeni t'ia përcjellim Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, u njoftua me, Raportin Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar-Shtator 2020; dhe i njëjti i përcjellët Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit dhe njoftimit. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Raportin Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020 dhe i njëjti i përcjellët Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe njoftim.

3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Për Sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i Financave, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për shumën e mjeteve të propozuara me u transferuar së në pikën 2 paragrafi 2.1 të Propozim Vendimit, më të cilat mjete do të mbulohen obligimet ndaj stafit mjekësor për shpërblimet jubilarë bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të arritur mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës Nr.05-3815 e datës 12.06.2018. për dallim nga sektori i arsimit, paga jubilarre në shëndetësi paguhet 100%.. Nëse realizohet ky vendim, në dhjetor do të iu procedohen mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për transfer të mjeteve buxhetore të kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, sipas buxhetit të vitit 2020; dhe i njëjti i,

Rekomandim

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i DAP i ka zhvilluar procedurat paraprake në këtë Draft Rregullore, me çka ka mbajtur Dëgjim publik me qytetarë. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Për me marrë pronë në shfrytëzim me pak së 1 vit, nuk e di së a do të kenë interesim qytetarët e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Këtu nuk është fjala vetëm për prona komunale-toka, por edhe për; park, lokal, etj. Sigurisht së ka pasur kërkesa që është hartuar ky draft. Nëse nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë Propozim Rregullore e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Ne në mbledhjen e kaluar e formuam një komision për hartimin e planit të punës së KK. Si komision jemi takuar në një mbledhje dhe kemi hartuar këtë draft plan të punës së KK. Plani është orientues sepse gjatë vitit ka me pasur edhe çështje tjera dhe mund të pësoj ndryshime. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Kërkoj që Plani të zbatohet në vitin 2021, pasi që në vitin 2020 nuk është zbatuar në tërësi plani, sepse nuk ka qenë disa tema të trajtuara në KPF dhe KK të parapara në planin e punës, si; Çështja e zbatimit të ligjit kundër pirjes së duhanit, i paraparë në mbledhjen e 8 të KK pastaj në mbledhjen e 7 ka qenë i paraparë në planin e punës së KK, Raporti për korrje shirje të komunës edhe kjo pikë nuk na ka ardhur për trajtim. Ne mundemi me shkruar pikë në planin e punës, por çështja është sesa do të zbatohet ky plan pune.

Kryesuesi i Kuvendit, Është e vërtetë atë që po thoni z. Ekrem, por nëse plani zbatohet në një përqindje të lartë, unë jam i kënaqur. Plani i Punës së KK sivjet është zbatuar pothuajse 90%. Në draft plan kemi lënë hapësirë edhe për pikë tjera të cilat mund të na adresohen për gjatë vitit. Viti 2021 është vit i zgjedhjeve dhe ka mundësi mbledhjet e fundit të mos mbahen, kështu që do shqyrtojmë mundësinë që dy mbledhjet e fundit me i mbajtur me herët. Diskutime të tjera nuk

ka, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e.

Aprovoj

Propozim Plan i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Kërkesa e anëtares së KK nga AAK, Rabiye Sallahi, për ndryshim plotësimit e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF);

Kryesuesi i Kuvendit, Ndryshim plotësimit e përbërjes në KPF duhet të bëhen pas kalimit të anëtarit në subjekt tjetër politik. Në ato që thirret anëtarja e KK znj. Sallahi, mendoj së ka të drejtë në bazë të UA, pa hyrë në atë së kush vjen. UA thotë që nëse anëtari kalon në subjekt tjetër politik, atëherë pozitën nuk e bartë në subjektin tjetër politik. Kushdo që ka diçka të paqartë mundet me iu drejtuar MAPL Unë nuk kam diçka me shtuar në këtë pikë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues; Unë e kam konsultuar UA 02/2018 që ka të bëjë me plotësimin ndryshimin e UA Nr. 03/2018 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë. Pikë së pari sipas këtij UA, kuvendet komunale kanë qenë të obliguara të bëjë harmonizimin e komiteteve të përhershme deri me 31 mars 2019, ndërkaq kjo nuk është bërë. Nëse do t'ishte bërë harmonizimi i komiteteve të përhershme, KPF do të kishte përbërjen prej të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në KK. Kuvendi i Komunës Kaçanik ka 6 subjekte politike dhe ka vend për të gjithë me u anëtarësuar në komitete. Pse nuk është bërë harmonizimi i vendimeve më UA të ri, ju e dini me mirë. Unë çështjen e zëvendësimit të anëtarit në KPF do të ngriti edhe në MAPL.

Kryesuesi, i Kuvendit, Për me marrë ulëse në KPF, merret parasysh rezultati i zgjedhjeve, kështu me kanë interpretuar MAPL jo për këtë rast, por kemi pasur rastin e Hajdar Loku, dhe ia kanë marrë mandatin në KPF pas kalimit të tij në subjekt tjetër politik. Neni 13 i UA e thotë qartë kur lëvizë një anëtar i një komitet obligativ nga një subjekt politik në subjekt tjetër, atëherë nuk e bartë pozitën që ka në atë komitet në subjektin tjetër politik.

z. Selim Reka, Raste të ndërrimit të anëtarit në KPF pas kalimit të tij në subjekt tjetër politik kemi pasur edhe më herët dhe të njëjti iu ka marrë mandati.

Kryesuesi i kuvendit, Unë kërkesën e adresoj në KK, është MAPL ajo që e definon këtë çështje. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që kjo kërkesë t'i adresohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Kërkesën e Rabiye Sallahi, për ndryshim plotësimit e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe e njëjta i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo pikë ka ardhur pak me vonesë, drejtori sigurisht e ka pasur ndonjë urgjencë që e ka sjellë me vonesë këtë çështje. Fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Me ligji e ri të tatimit në pronë, caktimi i normave tatimore nuk bëhet më në muajin shtator, ndërkaq KK vendosë për caktimin e normave tatimore në zonat industriale dhe atyre komerciale. Për me gjerë mund të iu jap sqarime të nevojshme zyrtari i TP, Xhelal Dema.

z. Xhelal Dema, Përshëndetje për të gjithë; Sa i përket vonesës për caktimin e normave tatimore, ne kemi pritur vlerësimin për zonat; industriale dhe komerciale, gjë që është dashur ministria me i sjellë deri me datën 30 tetor, mirëpo ata të ministrisë nuk kanë kthyer përgjigje në afatin e caktuar. Si komunë na mbetet me vendosur vetëm për normat tatimore për zonat; industriale dhe atyre komerciale, ndërkaq çështjet tjera i vendosë ministria. Afati i fundit me vendosë për normat tatimore është data 30 nëntor. Normat tatimore të përcaktuara janë të njëjtat si ato të vitit të kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj


Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka. Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:35.. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 7 anëtarë. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me datë 23 Nëntor 2020 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

